



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2019:180186  
Datë: 13.03.2024  
Numri i dokumentit: 05446045

Ac.nr.6654/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit gjeneral Kompania “D.L.R SH.P.K” , e sipas autorizimit G.Z , kundër të paditurit N.B, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.366/19, të datës 06.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 12.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurit N.B dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.366/19, të datës 06.07.2021.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.366/19, të datës 06.07.2021, ka vendosur më sa vijon:

**I.APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR**, kërkesë padia e paditëses: Byroja Kosovare e Sigurimeve **DETYROHET** i padituri N.B, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit, për aksidentin e dt. 25.07.2017, ti paguaj shumën në lartësi prej 699.00 euro, me kamatë ashtu siç bankat komerciale në Kosovë paguajnë për mjetet e deponuara nga qytetaret pa destinim të pacaktuare duke filluar nga datë 06.07.2021, e deri në pagesën definitive.

**II. DETYROHET** i padituri të ia paguajë shpenzimet e procedurës paditësit në shumën prej 20 euro, dhe prestimin nga pika I .dispozitivit te këtij aktgjykimi ti përmbush në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi ne dorëzim e nen kërcenim te përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës

së dytë ta aprovoj ankesën dhe ta prish aktgjykimin ankimor dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësja nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve, me datën 21.08.2019, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurit, për shkak të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 25.07.2017, me arsye sikurse në padi.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë ka filluar procedurën dhe pas marrjes së përgjigjes në padi, vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës ka marrë aktgjykimin e ankimuar me përmbajtje sikurse në dispozitivin e tij. Në arsyetim ka cekur se në bazë të raportit fillestar të aksidentit, procesverbalit mbi shikimin ( Raporti i zgjeruar), skica e vendit të ngjarjes të gjitha me numër 2017-DF-320, te datës 25.07.2017, gjykata ka konstatuar se: me datën 25.07.2017, në orën 10:00 h në rrugën Kline, ka ndodhur aksident trafiku, me lëndime të lehta trupore si dhe me dëme materiale, ku pjesëmarrës në këtë aksident ishte N.B , i cili ngiste veturën e markës VW Pasat me ngjyre te hirit me targa 03-240-AF, deri te aksidenti kishte ardhur përderisa automjetet ishin ne lëvizje ne drejtimin e njëjte dhe nga pakujdesia ne pjesën e parme godet automjetin Opel Corsa me ngjyre te bardhe me targa 01-326-GT dhe drejtuesi i automjetit H.S, nga goditja, godet veturën tjetër prapa lëviz dhe godet automjetin Daimler Crysler (Mercedes), duke shkaktuar me këtë rast aksident trafiku ne te cilin përveç dëmeve materiale dhe jo material ne te dyja automjetet, ndërsa nga ujdia jashtëgjyqësore më date. 25.10.2017, gjykata konstaton se i dëmtuari në këtë aksident H.S , përmes të autorizuarës avokatës E.N- B , ka lidhur marrëveshje me Byronë Kosovare të Sigurimeve - këtu paditësen, për kompensimin e dëmit material dhe jo material në shumën e tërësishme prej 699.00 euro të cilën pagesë e ka bërë përmes urdhër transferit të datës 30.10.2017, gjykata konstaton se Byroja Kosovare e Sigurimeve, ka bërë pagesën e detyrimit sipas ujdisë jashtëgjyqësore të lartë cekur në llogari bankare të autorizuarës së palës së dëmtuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar po ashtu theksohet se paditësja është dashur ta kompensoj dëmin të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt. 25.10.2017, në bazë të dispozitës së nenit 25 për Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto - përgjegjësisë, në të cilat shprehimisht parashihet se palët e treta të dëmtuara kanë të drejt ti paraqesin kërkesën për zhdëmtim drejt për drejt kompanisë së sigurimit, dhe nëse i dëmtuari parashtron kërkesën për zhdëmtim kompanisë së sigurimit, siguruesi si përgjigjeje në kërkesë të tillë nuk mund të bëjë kundërshtimet, që do të mund ti bënte ndaj të siguruarit në bazë të ligjit, ndërsa sipas dispozitës nga neni 18 paragrafi 4 të të njëjti ligje, Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar shpenzimet dhe kamatën.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e as në shkeljet e pretenduara me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara dhe nga përgjigja në padi rezulton se i padituri nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë e po ashtu edhe me ankesë i njëjti e pohon faktin vendimtar se shkaktar i aksidentit ka qenë vet i padituri i cili në momentin e sigurimit nuk ka pasur mbulesë të vlefshme të sigurimit, ndërsa në bazë të ujdës jashtë gjyqësore Nr.1139/17 e datës 25/10/2017, vërtetohet se paditësja me të dëmtuarin H.S kanë arritur marrëveshje për kompensimin e demit në lartësi prej 699.00 euro, ku në bazë të urdhër pagesës së datës 30/10/2017, vërtetohet shuma e paguar në lartësi prej 699.00 euro, respektivisht gjykata e shkallës së parë në këtë drejtim ka dhënë arsye të mjaftueshme të cilat i pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, ngase edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje juridike kontestuese. Sipas nenit 18 par.1 i përcakton se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga siguri i auto përgjegjësia, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*, par.4 i këtij neni përcakton se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.”*. Meqenëse, i padituri nuk ka pasur mbulesë të sigurimit, atëherë përgjegjësia e kompensimit ka rënë mbi paditësen, andaj e njëjta konform dispozitave ligjore të sipër theksuara ka të drejtë që të kërkojë rimbursimin për dëmin e paguar ndaj personave të tretë si pasojë e shkaktimit të atij dëmi nga ana e të paditurit. Në rastin konkret i padituri me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, andaj gjykata e shkallës së dytë, duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik-civil i të paditurit, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

Ac.nr.6654/21, me datë 12.03.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku